



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°14/2022

Hagë, 14/04/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen *Salih Mustafa*, gjatë gjithë kësaj jave janë mbajtur seanca gjyqësore. Deri tani, Mbrojtja e z. Mustafa ka thirrur dhjetë dëshmitarë për të dëshmuar. Si Mbrojtja dhe Prokuroria, ashtu edhe mbrojtësja e viktimave dhe Trupi Gjykues u kanë drejtuar pyetje disa prej dëshmitarëve. Pjesa më e madhe e dëshmive janë dhënë në seancë publike.

Seanca vijuese në këtë çështje është planifikuar për të mërkurën, më 20 prill në orën 9:30.

Me dorëzimin e versionit të redaktuar publik të dosjes gjyqësore përfundimtare nga Mbrojtja e Gucatit më 7 prill, tashmë dosjet gjyqësore të të gjitha palëve në çështjen *Gucati&Haradinaj* gjenden në faqen zyrtare të internetit të Dhomave të Specializuara.

Sot u mbajt konferenca mbi ecurinë në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, në të cilën Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një urdhër gojor, me të cilin e ndryshoi kalendarin për vazhdimin e procesit duke pasur parasysh parashtrimet e fundit të palëve. 31 gushti 2022 u caktua si datë provizore për kalimin e dosjes së çështjes trupit gjykues.

Në çështjen z. *Thaci dhe të bashkëakuzuarit*, Kryetare Trendafilova ditën e hënë caktoi një Panel të Gjykatës së Apelit pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake lejoi Mbrojtjen e Thaçit të apelonte vendimin e tij lidhur me kërkesën e ZPS-së për ndryshimin e listës së provave materiale dhe autorizimin e masave mbrojtëse në lidhje me të.





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°14/2022

Hagë, 14/04/2022

Ndër lajme të tjera: këtë javë ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i DHSK-së u takua me nxënësit e shkollës së mesme në Obiliq dhe Novobërdë si dhe shoqërinë civile në Kamenicë dhe Graçanicë.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

